


# Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

— dokument tremujor —

Korrik – Shtator 2022



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup



Ky projekt finansohet nga Bashkimi Evropian



# Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

Përmbledhje tremujore Korrik – Shtator 2022

## Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

## Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

## Redaktorët:

Dr. Simonida Kacarska  
Dr. Ardita Abazi Imeri

## Autorë:

Angela Delevska  
Angel Mojsovski  
Beba Zhagar

## Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:


Blerina Starova Zlatku

## Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, 2022

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Kjo përmbledhje paraqet zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE në Maqedoninë e Veriut për periudhën korrik – shtator 2022. Ai përfshin **ndjekjen e bazave të anëtarësimit në BE, duke përfshirë zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.**

## Zhvillimet kryesore

- » Shteti ka kryer diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara, duke mos i lejuar ata të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në zgjedhjet e fundit;
- » Qeveria revokoi kredencialet e Kryetarit të Komunës së Tetovës, për të cilën Kryetari pretendon se është akt hakmarrjeje;
- » Me zhvillimin e mbledhjes konstituive të Grupit të Punës, filloi hartimi i Strategjisë së re të Reformës Gjyqësore 2023-2027;
- » Me qëllim të përmbushjes së dispozitave ligjore të Ligjit të ri për Ndërmjetësim, u zgjodh Koordinator i parë Kombëtar për Ndërmjetësim dhe u zgjodhën anëtarët e Këshillit Kombëtar për Ndërmjetësim dhe u miratuan aktet nënligjore të parashikuara;
- » Zgjedhja e pasuksesshme e kryetar të ri të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë shkaktoi reagime në publik për mungesën e arsyeve për shpjegimin e vendimit. Është vënë në pyetje edhe paanshmëria e procedurës;
- » Propozim-verzioni i Kodit të Ri Penal iu bashkëngjiti përfundimisht Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Rregulloreve (ENER);
- » Parlamenti njëzëri përcaktoi nevojën për të miratuar ligje që kërkonin të rritnin pagat për punonjësit në veprimtaritë gjyqësore dhe të prokurorisë publike dhe policisë së burgjeve pas një procedure të shkurtuar;
- » Pas një periudhe të gjatë, Gjykata Administrative më në fund mori lokale të reja;
- » Akuzat e ndërsjellta midis kreut të DPF dhe kreut të PTHPNKOK, që rezultuan në dorëheqjen e kreut të DPF dhe pezullimin e kreut të PTHPNKOK, krijuan një rast shumë të diskutueshëm. Në mes të shtatorit, Këshilli i Prokurorëve Publikë filloi një procedurë për zgjedhjen e një shefi të ri të PTHPNKOK në prag të skadimit të mandatit të atij të mëparshëm dhe më 31 tetor;
- » Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve miratoi një Strategji të re Kombëtare për Parandalim dhe Drejtësi për Fëmijët për periudhën shtator 2022 - qershor 2027;
- » Në fund të korrikut, u miratua Strategjia për Barazinë Gjinore 2022-2027, duke vendosur kështu një kornizë gjithëpërfshirëse për aktivitete të mëtejshme në drejtim të promovimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave;
- » Më 20 shtator, propozim-ligji për Barazi Gjinore u publikua në ENER.

## Lista e shkurtesave

ASHMAA	Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
ACCMIS	Sistemi i automatizuar i informacionit për menaxhimin e çështjeve gjyqësore
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
AGJPP	Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
AQLI	Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
KZE	Komisioni për Zgjedhje dhe Emërime
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve çnjerëzore
QPS	Qendra për Punë Sociale
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
ENER	Regjistri Elektronik Kombëtar i Rregulloreve
IPE	Instituti i Politikave Evropiane
QEDR	Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve
BE	Bashkimi Evropian
DPF	Drejtoria e Policisë Financiare
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
HCHR	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
KNF	Klasifikimi ndërkombëtar i funksionalitetit
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
Këshilli i TIK	Këshilli për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Autoritetet Gjyqësore
IRL	Laboratori i Raportimit Investigativ
KGJRMV	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
LGBTI	Komiteti lezbik, homoseksual, biseksual, trans dhe interseksual
LMDP	Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
LPMD	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
KEMM	Këshilli i Etikës së Medias në Maqedoni
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MRT	Radio Televizioni i Maqedonisë
ASK	Agjencia e Sigurisë Kombëtare
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
AMDP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
PP	Zyra e Prokurorisë Publike
RM	Republika e Maqedonisë
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
ESHR	Enti Shtetëror i Revizionit
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
LSDM	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë
ISHP	Inspektorati Shtetëror i Punës
PSP	Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale në lidhje me, dhe që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve (Prokuroria Speciale Publike)
SPGM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve të Maqedonisë



# PËRMBAJTJE

<b>Funksionimi i institucioneve demokratike</b> .....	<b>6</b>
Zgjedhjet .....	7
Kuvendi .....	7
Qeverisja .....	8
Shoqëria Civile .....	9
Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë/inteligjencës .....	9
Reforma e Administratës Publike .....	10
<b>Kapitulli 23</b> .....	<b>11</b>
Funksionimi i gjyqësorit .....	12
Dokumente strategjike.....	12
Organet e menaxhimit .....	12
Pavarësia dhe paanshmëriay.....	13
Llogaridhënia .....	14
Profesionalizmi dhe kompetenca .....	14
Cilësia e drejtësisë .....	16
Efikasiteti.....	18
Lufta kundër korrupsionit .....	20
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.....	20
Organet qeverisëse.....	21
Pavarësia dhe paanshmëria .....	21
Prokuroria Publike .....	21
Kuadri ligjor .....	22
Të drejtat themelore .....	23
Avokati i Popullit .....	23
Objektet e burgut dhe paraburgimit.....	23
Mbrojtja e të dhënave personale .....	24
Liria e shprehjes.....	24
Sulmet ndaj gazetarëve.....	25
Censura e gazetarit .....	26
Të drejtat e fëmijës .....	26
Grupet e cenushme dhe parimi i mosdiskriminimit .....	27
Gjinia.....	29
Gjuha e urrejtes .....	32
LGBTI + .....	32
Romët.....	33

Funksionimi  
i institucioneve  
demokratike





Përveç këtyre aktiviteteve/propozimeve të opozitës, Kuvendi përballet me jofunksionalitet dhe joefikasitet, sipas deklaratave të dhëna nga kryetari i Kuvendit.<sup>8</sup> Kundërshtimet e tij qenë përqëndruar në atë nëse kryetarët e komisioneve parlamentare me qëllim nuk planifikojnë sesione komisionesh për shkak të vendimeve të tyre partiake apo politike.<sup>9</sup> Argumentet mes Kryetarit dhe deputetëve vazhduan gjatë gjithë verës, kështu që në momente të caktuara ai i qortoi deputetët për vlerësimin e seancave plenare të planifikuara, dhe kërkoi që ata ta respektonin atë si Kryetar të Kuvendit dhe vetë Kuvendin.<sup>10</sup> Ai i tha këto fjalë pas dështimit për të filluar punën pas seancës së 79-të të Kuvendit për shkak të mungesës së kuoromit, megjithëse 85 deputetë u nënshkruan si të pranishëm në lista (gjë që gjithashtu u jep atyre të drejtën për pagesa).<sup>11</sup> Për fat të mirë, një situatë e tillë nuk ndodhi, megjithëse problemet e deklaruara mbeten.

## Qeverisja

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ia mori kompetencat Kryetarit të Komunës së Tetovës, për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të shkollës së mesme. Shkarkimi vjen pasi drejtori i shkollës së mesme, përndryshe anëtar i stafit të partisë në pushtet nga qeveria qendrore, zbuloi abuzime gjatë një kontrolli të shkollës.<sup>12</sup> Ky vendim u përshëndet me shumë pakënaqësi nga qeveria bashkiake duke pretenduar se ky vendim është “një akt hakmarrjeje vetëm sepse kjo bashki nuk qeveriset nga qeveria qendrore aktuale”.<sup>13</sup> Megjithatë, Ministria e Arsimit i mohoi këto akuza, duke deklaruar se vendimi i tyre është marrë mbi bazën se “përveç indicieve dhe masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga Inspektorati Shtetëror Arsimor, bashkia nuk ka siguruar kryerjen e punimeve që përcaktohen me ligj si kompetencë e saj”.<sup>14</sup>

---

<https://www.slobodnaevropa.mk/a/32032215.html>.

8 ‘Xhaferi thirri kryetarët e Komiteteve për mosefikasitet të Kuvendit (Џафери ги прозва претседателите на комисиите за неефикасност на Собранието)’, *Sloboden pecat*, korrik 2022, <https://bit.ly/3FlxfJB>.

9 Ibid.

10 ‘Xhaferi i qortoi deputetët se u vonuan: Unë nuk jam një thes boksi, që ju të nxjerrni stresin tuaj mbi mua! (Џафери ги искара пратениците за доцнење: Не сум вреќа за удирање, па на мене да си ги лечите стресот!)’, *Fokus*, 29 gusht 2022 <https://bit.ly/3TG2IKL>.

11 ‘Talat Xhaferi: Unë do të propozoj një seancë për shpërndarjen e Parlamentit (Талат Џафери: Ќе предложам седница за распуштање на Собранието)’, *360 Stepeni*, 22 korrik 2022, <https://bit.ly/3gFhAu5>.

12 MASH ia mori kompetencat Kasamit për të emëruar drejtorin e shkollës së mesme (МОН му ги одзеде ингеренциите на Касами да именува директор на гимназијата)’, *Fokus*, 20 korrik 2022, <https://bit.ly/3TIlyff8>.

13 ‘Komuna e Tetovës: Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës është një akt politik hakmarrës (Општина Тетово: Одлуката на МОН е одмазднички политички чин)’, *Makfaks*, korrik 2022, <https://bit.ly/3Wauvom>.

14 ‘MASH ia mori kompetencat Kasamit për të emëruar drejtorin e shkollës së mesme (МОН му ги одзеде ингеренциите на Касами да именува директор на гимназијата)’, *Fokus*, 20 korrik 2022, <https://bit.ly/3TIlyff8>.



## Shoqëria Civile

Pas njoftimit, deri në miratimin e “propozimit francez” për hapjen e negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut, ka pasur një mori reagimesh negative.<sup>15</sup> Opozita e përshkroi debatin si shkatërrues për identitetin dhe gjuhën maqedonase. Sipas Qeverisë, të gjitha vijat e kuq nga ana e Maqedonisë së Veriut u respektuan, ndërsa opinioni i ekspertëve dhe organizatat e shoqërisë civile mbetën të ndara. Si rezultat, shoqëria u polarizua shumë. Diskursi u strukturua si “PRO” dhe “KUNDËR” Qeverisë, ndërsa çdo formë e kritikës ishte subjekt për ndarje të mëtutjeshme të brendshme. Situata u rëndua edhe më shumë nga raportet se fondet e BE-së do t’u shkurtohen OShC-ve që kundërshtojnë propozimin,<sup>16</sup> sipas të cilit Këshilli i Etikës i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë përcaktoi sjellje të pasaktë të mediave dhe shkëlqej të nenit 1 të Kodit të Gazetarëve.<sup>17</sup> Pas këtyre zhvillimeve, Kryeministri shprehu mbështetje për shoqërinë civile<sup>18</sup> dhe Komisioni Evropian gjithashtu u përgjigj me reagimin e tij mbi rëndësinë e pluralitetit të mendimeve.<sup>19</sup>

## Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë/inteligjencës

Lidhur me mbikëqyrjen civile të sektorit të sigurisë/inteligjencës, gara për të zgjedhur një pasues të drejtorit të ri të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare (ASK) ka filluar. Arsyeja për zgjedhjen e një drejtori të ri të ASK-së është se drejtori aktual po merr një pozicion të ri si ambasador i vendit në Republikën e Francës. Megjithatë kishte informacion të kufizuar, Shefi aktual i Ekstremizmit në Agjencinë e Sigurisë Kombëtare përmendet si një pasues i mundshëm.<sup>20</sup>

15 ‘Kontributi në konsultimet publike aktuale për propozimin e kornizës negociuese për Maqedoninë e Veriut për anëtarësimin në BE (Придонес кон тековните јавни консултации за предлог преговарачката рамка за Северна Македонија за пристапување во ЕУ)’, *Faqja zyrtare e Institutit për Demokraci – Societas Civilis -Shkup*, 4 korrik 2022 <https://bit.ly/3NaOwa4>.

16 ‘A do të shterren fondet e BE-së për shoqatat që janë kundër Propozimit Francez? Ќе секнат ли ЕУ фондовите за здруженијата кои се против францускиот предлог?’; *Zoom.mk*, 8 korrik 2022, <https://bit.ly/3Dg8ple>.

17 ‘Vendimi (Одлука), *Këshilli i Shoqatës për Etikën në Media në Maqedoni*’, 29 korrik 2022, <https://bit.ly/3spjMsm>.

18 ‘Faqja zyrtare në Facebook e Dimitar Kovaçevskit, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Официјална Фејсбук страница на Димитар Ковачевски, претседател на Владата на Република Северна Македонија)’, 9 korrik 2022 <https://www.facebook.com/Dimitar.Kovacevski/posts/pfbid0q2mazJSguHuBvkx6fkmUG5k8sMNGwXRLjPUMNYDkDkZrgrCovcm>.

19 ‘Ne kurrë nuk do t’i pezullojmë fondet e BE-së për shkak të një mendimi të ndryshëm, pretendon Komisioni Evropian (Никогаш нема да суспендираме ЕУ фондови поради различно мислење, тврдат од Европска комисија)’, *eMagazin*, 12 korrik 2022, <https://emagazin.mk/nikogash-nema-da-suspendirame-eu-fondovi-poradi-razlichno-misle-e-velat-od-evropska-komisi-a/>.

20 Zare Milloshevski është kandidati më serioz për drejtor të ri të Agjencisë së Sigurisë Kombëtare (Заре Милошевски најсериозен кандидат за нов директор на Агенцијата за национална безбедност) A1on, 21 shtator, 2016 <https://bit.ly/3NSAH0g>

# Reforma e Administratës Publike

Në korrik, Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës filloi një dëgjim publik mbi ligjin e paralajmëruar prej kohësh mbi Regjistrin Qendror të Popullsisë.<sup>21</sup> Qëllimi i 'Regjistrin Qendror të Popullsisë' është që qytetarët të informohen për të dhënat që kanë në institucione, kush i ka aksesuar ato, kur dhe në bazë të cilave rregullore ligjore.<sup>22</sup>

Duke u mbështetur në Regjistrin Qendror të Popullsisë si dhe në rezultatet e Regjistrimit 2021, MSHIA bëri një ndryshim në mjetin 'balancues',<sup>23</sup> duke ndryshuar përqindjet e marra nga Regjistrimi. Këto ndryshime i referohen përqindjeve të popullsisë të numëruar në diasporë, të cilat më pas u pritën me protesta publike. Me këtë rast, kreu i Zyrës Shtetërore të Statistikave (institucioni kryesor që kreu regjistrimin) foli dhe deklaroi se "e vetmja kategori e vlefshme është popullsia rezidente" dhe se "është në përputhje me të gjitha standardet e Kombeve të Bashkuara, të cilat janë të vlefshme për të gjitha vendet në botë dhe të pranuar nga Eurostat."<sup>24</sup>

Lidhur me Administrimin e Burimeve Njerëzore, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale njoftoi krijimin e një "marrëveshjeje të re kolektive" për punonjësit në sektorin publik. Kjo marrëveshje e re duhet të sigurojë të drejta më të mëdha për punëtorët dhe metodologjia e re do të sigurojë një rritje të vazhdueshme të pagave të punonjësve.<sup>25</sup>

Lajm i mirë në fushën e Dorëzimit të shërbimeve, sipas Ministrit të Punëve të Brendshme, i cili deklaroi se nga janari i vitit të ardhshëm, certifikata e shtetësisë do të lëshohet në formë elektronike përmes Portalit Kombëtar për shërbime elektronike ose përmes dorëzimit të kualifikuar elektronik të regjistruar në një adresë elektronike.<sup>26</sup> Shtetasit do të jenë në gjendje të paraqesin kërkesa për lëshimin e një karte identiteti dhe pasaporte në mënyrë elektronike. Kjo për shkak të "ndryshimeve në Ligjin për Kartat e Identitetit, Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit, Ligjin për Emrin Personal dhe Ligjin për Regjistrimin e Qëndrimit dhe Banimit."<sup>27</sup>

21 Debat publik për propozim-ligjin për Regjistrin Qendror të Popullsisë (Јавна расправа за предлог-закон за Централен регистар на население), *Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës*, 27 korrik 2022, <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/4143>.

22 "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrin Qendror të Popullsisë (Закон за изменување и дополнување на Законот за централен регистар на население)," *Regjistri Elektronik Kombëtar i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut-ENER*, 12 korrik 2022, [https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=74974](https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=74974)

23 "MSHIA: Një ndryshim u bë në mjetin e uebit 'Balancuesi' sipas rezultateve të regjistrimit të kryer në vitin 2021 (МИОА: Направена промена во веб алатката „балансер“, согласно резултатите од спроведениот попис во 2021 година)," *Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës*, 5 gusht 2022, <https://mioa.gov.mk/?q=mk/nyja/4157>.

24 Simovski kundër Alitit për ndryshimet në 'balancuesin': E vetmja kategori e vlefshme është popullsia rezidente (Симовски контра Алити за измените во „балансерот“: Единствена валидна категорија е резидентното население), *360 Stepeni*, 17 gusht 2022 <https://bit.ly/3FKS6MZ>.

25 'Një marrëveshje e re e përgjithshme kolektive për sektorin publik që do të sigurojë rritjen e pagave, njoftoi Trençevska (Нов општ колективен договор за јавниот сектор што ќе обезбеди раст на платите, најави Тренчевска), *Nova Makedonija*, 20 shtator 2022 <https://bit.ly/3Da4Kf7>.

26 'Që nga janari, kërkesa për pasaportë dhe kartë identiteti është dorëzuar në mënyrë elektronike (Од јануари барање за пасош и лична карта по електронски пат), *Fokus*, 18 gusht 2022 <https://bit.ly/3zky1b>.

27 Ibid.

# Kapitulli 23

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) njoftoi më 27 korrik se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) do t'i japin Maqedonisë së Veriut 4.3 milionë dollarë amerikanë si pjesë e zbatimit të Dialogut Strategjik midis dy vendeve,<sup>28</sup> duke kontribuar kështu në forcimin e sundimit të ligjit në vend.<sup>29</sup>

Më 27 shtator 2022, takimi shpjegues i Acquis Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, si kapitulli i fundit i Grupit 1, u mbajt në Bruksel, kur Komisioni Evropian paraqiti legjislacionin e ri për këtë fushë. Shqyrtimi i ndërsjelltë i Kapitullit është njoftuar për javën e parë dhe të dytë të dhjetorit, kur vendi do të paraqesë shkallën e përputhshmërisë me ligjet e BE-së, strukturën institucionale për zbatimin e ligjeve të harmonizuara dhe planet për përputhshmërinë e mëtejshme, ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative, si dhe burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe të TI-së për zbatimin e standardeve evropiane.<sup>30</sup>

28 Dialogu strategjik filloi më 2 qershor në Uashington, midis delegacioneve qeveritare të të dy vendeve. Dialogu strategjik është një forum që siguron një kuadër për marrëdhënie të ndërsjellta dhe bashkëpunim në mbrojtje, ekonomi, arsimit, transport, energji, ndryshim klimatik, zhvillim demokratik, luftë kundër korrupsionit, sundim të ligjit, tregti dhe çështje të tjera me interes të ndërsjelltë.

29 'SHBA po dërgon 4.3 milionë dollarë në Maqedoninë e Veriut për të forcuar sundimin e ligjit (САД праќаат 4,3 милиони долари на Северна Македонија за зајакнување на владеење на правото)', *Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty*, 27 korrik 2022, <https://bit.ly/3zdaofl>.

30 'Një ekip nga Ministria e Drejtësisë në Bruksel në një takim për Kapitullin 23 "Drejtësia dhe të Drejtat Themelore", i cili përfundon takimet shpjeguese të shqyrtimit për Grupin 1, i njohur si "Themelet" (Тим на Министерството за правда во Брисел на состанок за Поглавјето 23 „Правосудство и Фундаментални права“, со кој завршуваат објаснувачките скрининг состаноци за Кластер 1, познат како „Темели“), *Faqja Zyrtare e Ministrisë të Drejtësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, 27 shtator 2022, <https://www.facebook.com/MinisterstvoPravda/posts/pfbid031TzhMoFtGhh1UNdGJfr5Es54UaFS-GeqGhJrhjC6vzYTTGKM4r98aCVujSsE1vfol>.



# Funksionimi i gjyqësorit

## Dokumente strategjike

Më 5 shtator, u mbajt takimi i parë konstituiv i Grupit të Punës për hartimin e Strategjisë së re Gjyqësore 2023-2027.<sup>31</sup>

## Organet e menaxhimit

Më 7 shtator, Këshilli Gjyqësor shpalli Programin dhe Planin e Veprimit 2022 - 2025 për Parandalimin dhe Monitorimin e Korrupsionit në Gjyqësor<sup>32</sup>, i cili duhet të kontribuojë në zvogëlimin e korrupsionit, përmirësimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies së trupës së gjyqtarëve, duke siguruar kësh-tu besim më të lartë të publikut në sistemin gjyqësor.<sup>33</sup>

Pasi ndryshimet e Ligjit për marrëdhënie pune që supozojnë të zgjasnin angazhimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publik për tre vjet të tjera nuk u miratuan nga Kuvendi,<sup>34</sup> Këshilli Gjyqësor, në një seancë të mbajtur më 1 korrik 2022, nxori në pension 42 gjyqtarë që plotësonin kushtet për pension pleqërie, dhe të cilëve u kishte zgjatur mandatin bazuar në mundësinë e mëparshme ligjore.<sup>35</sup> Konkretisht, në lig-jin për Këshillin Gjyqësor nuk parashikohet mandati i gjyqtarëve, por nga ana tjetër, një anëtar i Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve mund të jetë gjyqtar aktiv, si rrjedhojë dy anëtarë kanë dalë në pension në korrik 2022,<sup>36</sup> dhe një tjetër në pension në gusht 2022.<sup>37</sup> Më pas është bërë shpallja për zgjedhjen e gjyqtarëve<sup>38</sup> e cila është realizuar në mesin e njëjësive zgjedhore në vijim: Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata e Apelit Shkup dhe Gjykatat Administrative dhe Gjykata e Apelit Gosti-var.<sup>39</sup> Pas formimit të Komisionit për Zbatimin e Zgjedhjeve<sup>40</sup> dhe përgatitjes së listave të kandidatëve për

31 'Takimi konstituiv i Grupit të Punës për Zhvillimin e Strategjisë së Re Gjyqësore 2023-2027 (Конститутивен состанок на работната група за изработка на новата судска стратегија 2023-2027 година)', *Faqa zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 5 shtator 2022, <https://bit.ly/3TZN2Sa>.

32 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 'Programi 2022-2025 dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Monitorimin e Korrupsionit në Gjyqësor' (Програма и акционен план за превенција и следење на корупцијата во судството 2022 – 2025), *Faqa zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 7 shtator 2022, <https://bit.ly/3N8p6tK>.

33 'Me një Program Kundër Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor do të parandalojë dhe zbulojë korrupsionin në gjyqësor (Со антикорупциска програма Судскиот совет ќе превенира и открива корупција во судството)', *MIA - Agjencia e Informacionit për Median*, 7 shtator 2022, <https://bit.ly/3Dec5dL>.

34 Ndryshimet në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës u propozuan në fund të qershorit 2022 në pjesën për ndërprerjen e kontratës së punës, me dispozita për përjashtim për gjyqtarët dhe prokurorët publikë dhe dispozita për zgjatjen e mandatit të tyre. Vlefshmëria e përkohshme e këtyre dispozitave u propozua të zgjasë deri në tre vjet në mënyrë që të mbahen të plotësuar pozitave në gjykata dhe zyrat e prokurorisë publike, deri në ardhjen e stafit të ri nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.

35 'Njoftim nga seanca e 407-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-së- 07/01/2022 (Соопштение од 407-та седница на Судскиот Совет на РСМ - 01.07.2022 година)', *Faqa zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, <https://bit.ly/3TVoHgq>.

36 Anëtarë të Këshillit Gjyqësor të pensionuar nga radhët e gjykatësve- Kiro Zdraev nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Zoran Teofilovski nga Gjykata e Apelit në Gostivar.

37 Anëtarja e Këshillit Gjyqësor u pensionua nga radhët e gjykatësve- gjykatësja Gordana Spirevska nga Gjykata Themelore Penale Shkup. 'Njoftim për seancën e 411-të të Këshillit Gjyqësor të RMV-së- 08/09/2022 (Соопштение за 411-та седница на Судскиот Совет на РСМ- 09.08.2022 година)', *Faqa zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, <https://bit.ly/3zh117A>.

38 'Njoftim për publikun në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjykatësve (Соопштение на јавноста за избор на членови на Судскиот совет на Република Северна Македонија од редот на судиите)', *Faqa zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 15 shtator 2022, <https://bit.ly/3TCrPyb>.

39 'Njoftim nga Seanca e 412-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-së (Соопштение од 412-та седница на Судскиот совет на РСМ- 17.08.2022 година)', *Faqa zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 17 gusht 2022, <https://bit.ly/3SD2rXF>.

40 'Njoftim nga Seanca e 413-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-së- 24.08.2022 (Соопштение од 413-та седница на Судскиот совет на РСМ - 24.08.2022 година)', *Faqa zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, <https://bit.ly/3D7NQQF>.

zgjedhjen e anëtarëve,<sup>41</sup> më 14 shtator, u zgjedhën tre anëtarët e rinj të Këshillit Gjyqësor.<sup>42</sup> Tre anëtarët e rinj u betuan në parlament në 19 shtator, duke hyrë kështu zyrtarisht në postet e tyre të reja.<sup>43</sup> E gjithë procedura ishte transparente dhe numërimi i votave për zgjedhjen e anëtarëve u shfaq publikisht.<sup>44</sup>

## Pavarësia dhe paanshmëria

Në korrik, Këshilli Gjyqësor i Hapur mbajti seancën e dytë në të cilën u miratuan Rregullat e Procedurës së Këshillit Gjyqësor të Hapur.<sup>45</sup> Në seancë u zgjedhën edhe bashkëkryetarët e Këshillit për Gjyqësi të Hapur.<sup>46</sup>

Sipas procesverbalit të publikuar të inspektimit të kryer në Gjykatën Themelore Penale Shkup<sup>47</sup> dhe Gjykatën e Lartë Administrative Shkup<sup>48</sup> nga Ministria e Drejtësisë, në lidhje me funksionalitetin e sistemit ACCMIS, ekziston nevoja për të harmonizuar sistemin ACCMIS me rregulloret dhe normat në fuqi dhe gjyqësorin administrativ.<sup>49</sup> Në përputhje me të lartpërmendurën, nevojitet gjithashtu efektivitet më i madh dhe përcaktim më i qartë i kompetencave të organit të punës në Gjykatën e Lartë për Standardizimin e Procedurave Gjyqësore gjatë përdorimit të ACCMIS.<sup>50</sup>

Lidhur me përmirësimin e sistemit ACCMIS, anëtarët e Këshillit Gjyqësor, së bashku me anëtarët e Këshillit për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Autoritetet Gjyqësore (Këshilli i TIK), zhvilluan një takim me Këshillin Gjyqësor të Mbretërisë së Norvegjisë.<sup>51</sup> Në takim, u theksua gatishmëria e Norvegjisë, së bashku me donatorë të tjerë, për të investuar 6.8 milionë euro për përdorim më të shpejtë, më të përshtatshëm dhe më të plotë të teknologjisë së informacionit dhe instalimin e një sistemi të ri ACCMIS.<sup>52</sup>

41 'Listat e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve (Кандидатски листи за избор на членови на Советот од редот на судиите)', *Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 11 gusht 2022, <https://bit.ly/3TZS4h0>.

42 'Njoftim për publikun në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjykatësve (Соопштение на јавноста за избор на членови на Судскиот совет на Република Северна Македонија од редот на судиите)', *Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 15 shtator 2022 <https://bit.ly/3DhGuYG>.

43 'Anëtarët e rinj të Këshillit Gjyqësor dhanë një deklaratë solemne, plani për të luftuar korrupsionin është duke i prituri ata në tryezë (Новите членови на Судскиот совет дадоа свечена изјава, на маса ги чека планот за борба против корупција)', *360 Stepeni*, 19 shtator 2022, <https://360stepeni.mk/novite-chlenovi-na-sudskiot-sovet-dadoa-svecena-izjava-na-masa-gi-cheka-planot-za-borba-protiv-korupsija/>.

44 'Numërimi i votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjykatësve (Броеје на гласови од изборот на членови на Судски совет од редот на судиите)', *Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 16 shtator 2022, <https://bit.ly/3DwPQkw>.

45 'Këshilli i Gjyqësorit të Hapur miratoi Rregullat e Procedurës dhe bashkë-kryesuesit e zgjedhur (Советот за отворено судство го усвои Деловникот за работа и избра ко-претседатели)', *Faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 13 korrik 2022, <https://bit.ly/3gLP3TR>.

46 Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, dhe menaxheri i programit në Qendrën për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Zharko Haxhi-Zafirov, u zgjedhën bashkëkryesues.

47 'Procesverbali i Inspektimit në Gjykatën Themelore Penale në Shkup (Записник од увид во Основен кривичен суд Скопје)' (Ministria e Drejtësisë, 6 qershor 2022), <https://pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zapisnik%20za%20Osnoven%20krivicen%20sud%20za%20objava.pdf>.

48 'Procesverbali i Inspektimit në Gjykatën e Lartë Administrative në Shkup (Записници од увид во Виш управен суд Скопје)' (Ministria e Drejtësisë, 6 qershor 2022), <https://pravda.gov.mk/Upload/Documents/Zapisnik%20za%20Vis%20upraven%20%20sud%20za%20objava.pdf>.

49 'Procesverbali i një inspektimi të funksionalitetit të ACCMIS (Записници од извршен увид во функционалноста на АКМИС)', *Akademik*, 29 korrik 2022, <https://akademik.mk/zapisnitsi-od-izvrshen-uid-vo-funksionalnosta-na-akmis/>.

50 Ibid.

51 'Takim në Këshillin Gjyqësor: Norvegjia do të dhurojë një sistem të ri ACCMIS, Gjyqësori do të bëhet më i pavarur dhe më transparent (Средба во Судскиот совет: Норвешка ќе донира нов АКМИС систем, судството ќе стане понезависно и потранспарентно)', *Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 19 shtator 2022, <https://bit.ly/3gOTb5k>.

52 Ibid.

## Llogaridhënia

Prokuroria Publike po vepron në kallëzimin penal të dorëzuar nga Drejtoria e Policisë Financiare<sup>53</sup> për kërkimin që hetuesit nga PTHPNKOK e kanë kryer më 18 gusht 2022 në hapësirat e institucionit.<sup>54</sup> Përkatësisht, pas mbikëqyrjes dhe inspektimit të rastit, u vërtetua se duke vepruar në një ankesë anonime penale, të cilën PTHPNKOK e mori gjatë muajit maj 2022, u shkel kompetenca horizontale dhe organizimi i Prokurorisë Publike.<sup>55</sup> Që do të thotë, meqenëse kallëzimi penal i pranuar i referohet personave nga Drejtoria e Policisë Financiare, të cilët sipas nenit 33 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurorinë Publike kanë kompetenca policore, Departamenti i Specializuar për Ndjekjen e Krimeve të Kryera nga Personat me Fuqi Policore dhe Anëtarët e Policisë së Burgjeve është përgjegjës për trajtimin e raporteve të tilla.<sup>56</sup> Për rrjedhojë, tre prokurorët publikë nga PTHPNKOK që kanë vepruar në këtë rast, dhe nuk janë pjesë e Departamentit të Specializuar, kanë vepruar pa autoritet në kallëzimin penal.<sup>57</sup> Gjithashtu, me mbikëqyrjen, Prokuroria Publike konstatoi se kërkesa për lëshimin e urdhër-arrestit, e dorëzuar në Gjykatën Themelore Penale Shkup, ishte e pabazë.<sup>58</sup> Pas kësaj, filloi procedimi disiplinor ndaj tre prokurorëve publikë, i cili rezultoi në pezullimin e drejtuesit të PTHPNKOK.<sup>59</sup>

## Profesionalizmi dhe kompetenca

Ndryshimet e paraqitura në ligjin për marrëdhëniet e punës, që ofrojnë përjashtim për gjyqtarët dhe prokurorët publikë dhe zgjatje të mandatit të tyre deri në tre vjet, nuk u pranuan nga partitë opozitare në Kuvend, duke rezultuar në daljen në pension të 42 gjyqtarëve dhe dhjetë prokurorëve më 1 korrik, 2022.<sup>60</sup> Pritet që pensionimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë të rezultojë në riorganizimin e gjyqësorit dhe prokurorisë,<sup>61</sup> që do të thotë gjithashtu vendosje dhe rinisje të procedimeve gjyqësore për një numër të madh rastesh, me rrezikun që ato të vjetërsohen. Procedimet gjyqësore që lëvizin ngadalë ka gjasa të zgjaten më shumë duke ditur numrin e reduktuar të gjyqtarëve në shumë gjykata. Nga ana tjetër, shtatë gjyqtarë nga 42 gjyqtarë, të pakënaqur me daljen e tyre në pension më 1 korrik, paraqitën ankesa dhe kundërshtime në Këshillin Gjyqësor, por ata u shkarkuan.<sup>62</sup> Në të njëjtën kohë, drejtori i Akademisë për

53 'Policia Financiare dorëzoi një ankesë në Prokurorinë Publike në lidhje me Kërkimin e kryer në Hapësirat e saja (Финансиската полиција поднесе претставка до ЈО за извршениот претрес во нејзините простории)', *360 Stepeni*, 25 korrik 2022, <https://360stepeni.mk/finansiskata-politsija-podnese-pretstavka-do-jo-za-izvrsheniot-pretres-vo-nejzinite-prostorii/>.

54 'Kërkimi në Policinë Financiare, Ruskovska nuk zbulon detaje (Претрес во финансиска полиција, Русковска не открива детали)', *Radio Evropa e Lirë*, 18 korrik 2022, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/31948748.html>.

55 'Njoftim (Соопштение)', *Faqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 1 gusht 2022, <https://jorm.gov.mk/soopshtenie-108/>.

56 Ibid.

57 Ibid.

58 Ibid.

59 'Vilma Ruskovska pezullohet, disiplinore për dy prokurorë të tjerë (Вилма Русковска е суспендирана, дисциплинска постапка за уште две обвинителки)', *NetPress*, 16 gusht 2022, <https://netpress.com.mk/vilma-ruskovska-suspendirana-disciplinska-za-ush-te-dve-obvinitelki/>.

60 'Gjyqtarët dhe prokurorët publikë që kanë mbushur 62 ose 64 vjet dalin në pension (Судиите и јавните обвинители кои наполнија 62 или 64 години заминуваат во пензија)', *MIA*, 1 korrik 2022, [shorturl.at/hoy39](https://shorturl.at/hoy39).

61 'Riorganizimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve - Tupançevski: Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve do të ngarkohen me këtë (Реорганизација на судии и обвинители – Тупанчевски: Тоа ќе го направи Советот на судии и обвинители)', *TV 21*, 6 korrik 2022, <https://mk.tv21.tv/reorganizatsija-na-sudii-i-obviniteli-tupanchevski-toa-ke-go-napravi-sovetot-na-sudii-i-obviniteli/>.

62 Gjyqtarë nga Manastiri, Shtipi dhe Strumica, duke përfshirë dy kryetarë gjykatash, argumentuan se vendimi i këshillit për t'i pensionuar ata ishte në kundërshtim me Kushtetutën, se jeta e tyre e punës tashmë ishte zgjatur përtej moshës 64 vjeç, por gjithashtu se Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës, i cili nuk u votua më 1 korrik, është ende në procedurë parlamentare. Përveç kësaj, shtuan se ata duhet të përfundojnë mandatin e tyre 4-vjeçar si kryetarë. 'Këshilli Gjyqësor nuk pranoi kundërshtimet e gjyqtarëve, ata duhet të pensionohen (Судскиот совет не ги прифаќа приговорите на судиите, мора да бидат пензионирани)', *Skopje 24*, 23 korrik 2022, <https://bit.ly/3zkUsYy>.

Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë deklaroi se 59 gjyqtarë dhe prokurorë të rinj do të jenë gati të bashkohen në sistemin ligjor deri në fund të vitit dhe të plotësojnë vendet boshe në gjykatat dhe zyrat e prokurorisë publike.<sup>63</sup> Përveç kësaj, Ministri i Drejtësisë vuri në dukje se dy poste u plotësuan nga përzgjedhja e Zyrave të Prokurorisë së Lartë Publike në Manastir dhe Shtip.<sup>64</sup> Shoqata e Administratës së Gjykatës reagoi ndaj qëndrimit të autoriteteve kompetente shtetërore që u përpoqën të zgjidhnin këtë problem të gjatë në moment të fundit.<sup>65</sup> Në përgjigjen e tyre, ata theksuan sërish mundësinë, përmes trajnimit fillestar të shkurtuar, për të lehtësuar rekrutimin e stafit gjyqësor që kryen profesionalisht detyrat e tyre të punës si bashkëpunëtor gjyqësor ose këshilltar për shumë vite në të gjitha departamentet gjyqësore të gjykatave.<sup>66</sup>

Vendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë për të publikuar një njoftim për zgjedhjen e katër prokurorëve publikë në PTHPNKOK, mandati i të cilëve përfundoi në muajt qershor dhe gusht, u mor më 14 prill 2022.<sup>67</sup> Gjashtë prokurorë publikë aplikuan për thirrjen.<sup>68</sup> Megjithatë, Këshilli nuk ka vepruar ende mbi këtë njoftim. Seanca zgjedhore në shtator u shty për herë të tretë dhe prokurorët publikë nuk janë zgjedhur.<sup>69</sup> Si arsye kryesore për vonesën, Këshilli përmend mosvënien në dispozicion të të gjitha materialeve të nevojshme që janë kërkuar nga prokuroria kompetente për kandidatët dhe nevojën për një analizë më të detajuar të punës së tyre të mëparshme.<sup>70</sup>

63 '59 Prokurorë dhe Gjyqtarë të rinj- Gaber: Deri në fund të vitit, do të ketë një thirrje të re (59 нови обвинители и судии – Габер: До крајот на годинава ќе има нов повик)', 22 shtator 2022, <https://mk.tv21.tv/59-novi-obviniteli-i-sudii-gaber-do-krajot-na-godinava-ke-ima-nov-povik/>.

64 'Pika të shkurtra nga paraqitja në lajmet e Sitel të ministrit Tupançeski (Кратки поенти од гостување во дневникот на Сител на министерот Тупанчески)', Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 shtator 2022, <https://bit.ly/3D7S5JD>.

65 'Shoqata e Administratës së Gjykatës: Sot gjykatat në Maqedoni do të mbeten pa një numër të madh gjyqtarësh (Здружението на судската администрација: Денес судовите во Македонија ќе останат без поголем број судии)', *MakPress.Mk*, 1 korrik 2022, <https://bit.ly/3TFmlgA>.

66 Ibid.

67 Kontribut në Përmbledhjen e Tremujorit nga Koalicioni "Të gjithë për Gjykime të Drejta".

68 'Vetëm gjashtë kandidatë për katër pozicionet vakante në Prokurorinë Publike (Само шест кандидати за испразнетите четири места во јавното обвинителство)', *Kanal 5*, 20 shtator 2022, <https://kanal5.com.mk/samo-shest-kandidati-za-ispraznetite-chetiri-mesta-vo-javnoto-obvinitelstvo/a547741>.

69 'Seanca për përzgjedhjen e 4 prokurorëve të rinj në Prokurorinë për ndjekjen e krimit të organizuar është shtyrë për herë të tretë (По трет пат одложена седницата за избор на 4 нови обвинители во Обвинителството за гонење организиран криминал)', *Telma TV*, 20 shtator 2022, <https://telma.com.mk/2022/09/20/po-tret-pat-odlozhena-sednicata-za-izbor-na-4-novi-obviniteli-vo-obvinitelstvo-za-gonenje-organiziran-kriminal/>.

70 Ibid.

## Cilësia e drejtësisë

Sipas prezantimit të Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit në Ligjin e ri për Ndërmjetësimin,<sup>71</sup> në sesionin e 54<sup>-të</sup> të Qeverisë, Zëvendëskryetari i Dhomës së Tregtisë së Maqedonisë së Veriut dhe Kryetari i Shoqatës së Ndërmjetësimit të Dhomës, Dr. Jelisaveta Georgieva Jovevska, u emërua si Koordinatorja e parë Kombëtare e Ndërmjetësimit.<sup>72</sup> Bazuar në thirrjen e hapur për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit, u zgjodhën edhe<sup>73</sup> anëtarë të këshillit.<sup>74</sup> Procesi i miratimit të të gjitha akteve nënligjore të parashikuara përfundoi<sup>75</sup> me miratimin e rregullores tarifore për ndërmjetësuesit.<sup>76</sup>

Në prag të skadimit të mandatit të Kryetarit aktual të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (AGJPP) në fund të këtij viti, Bordi Administrativ i AGJPP publikoi një thirrje publike për zgjedhjen e një presidenti të ri më 14 korrik.<sup>77</sup> Drejtoresha e tanishme, Natasha Gaber-Damjanovska dhe gjykatësja e Gjykatës Themelore Penale të Shkupit, Olja Ristovska, u paraqitën për thirrjen. Ndonse u tha se ata janë të përshtatshëm për postin dhe përmbushin të gjitha kriteret e dhëna, asnjëri prej tyre nuk mori pesë votat e kërkuara ligjërisht.<sup>78</sup> Nuk u shpjegua abstenimi nga votimi i anëtarëve të Bordit Administrativ.<sup>79</sup> Thirrja dështoi dhe Bordi Administrativ do të lëshojë një thirrje të re.<sup>80</sup>

Gjatë periudhës raportuese janë hartuar ose filluar disa rregullore ligjore. Së pari, me shpalljen e përgatitjes së një ligji të ri penal dhe risitë që do të prezantohen me të, më 7 korrik propozim-verzioni i bashkëngjijtë përfundimisht Regjistrin Elektronik Kombëtar të Rregulloreve (ENER).<sup>81</sup> Së dyti, më 8 korrik u mbajt një seancë konstituive e Grupit të Punës për Hartimin e Kodit të Ri Civil të Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>82</sup> Së treti, më 15 korrik u përgatit dhe u publikua një ligj i ri për pasurinë e konfiskuar, përfitimin e

71 'Ligji për Ndërmjetësim (Закон за медијација)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 294/2021.

72 'Jelisaveta Georgieva-Jovevska, Koordinatorja e parë Kombëtare për Ndërmjetësim (Јелисавета Георгиева-Јовевска прв национален координатор за медијација)', AIM - Agjencia e Informacionit për Median, 6 korrik 2022, <https://bit.ly/3VYfT1B>.

73 'Thirrje publike për shprehjen e interesit për të marrë pjesë në Këshillin Kombëtar të Ndërmjetësimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Јавен оглас за искажување на интерес во Националниот совет за медијација)', Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 20 korrik 2022, <https://vlada.mk/node/29660>.

74 'Vendimi për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit (Решение за именување на членови и секретар на Националниот совет за медијација)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 201/2022.

75 "Deklarata e Zëvendësministrit të Drejtësisë në Konferencën përfundimtare," Përdorimi i ndërmjetësimit- Sukseset e arritura dhe sfidat e mbetura "", Faqja zyrtare e Institutit të Politikave Evropiane-Shkup, 16 shtator 2022, <https://epi.org.mk/post/22207>.

76 'Libri i rregullave tarifore për ndërmjetësuesit (Тарифник за медијатори)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 194/2022.

77 'Shpallja për zgjedhjen e Drejtorit të AGJPP-së (Оглас за избор на директор на АСЈО)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 160/2022.

78 'Pesë anëtarë të Bordit Menaxhues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë e shtynë zgjedhjen e Drejtorit, nuk thanë se pse nuk votuan (Петмина членови на Управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители го бутнаа изборот на директор, не кажаа зошто не гласале)', Sakam Da Kazam, 30 gusht 2022, <https://bit.ly/3gKZHTQ>

79 Ibid.

80 'Bordi Drejtues i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë nuk ka zgjedhur një drejtor, ai do të shpallë një thirrje të re (Управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители не избра директор, ќе распишува нов оглас)', 30 shtator 2022, <https://360stepeni.mk/upravniot-odbor-na-akademijata-za-sudii-i-javni-obviniteli-ne-izbra-direktor-ke-raspishuva-nov-oglas/>.

81 Ministria e Drejtësisë, 'Propozimi i Kodit Penal (Предлог на Кривичен законик)' (Regjistri Kombëtar Elektronik i Rregulloreve- ENER, 7 korrik 2022), [https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub\\_regulation&subitem=view\\_reg\\_detail&itemid=74071](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=74071).

Një shembull tjetër i censurës së gazetarëve mund të shihet kur oficerët e policisë nga stacioni policor i Negotinos paralajmëruan një gazetare në bazë të një ankese rreth artikullit të saj të shkruar ndaj të cilit SHGM reagoi se procedura e MPB për të paralajmëruar gazetarët për shkak të një teksti të botuar është e papërshtatshme dhe e panevojshme, pasi ushtron presion mbi lirinë e shprehjes së gazetarëve.<sup>142</sup>

Një tjetër incident i ngjashëm u raportua në fillim të gushtit, kur dy gazetarë u ndaluan të raportonin mbi çështjet e të drejtave të punës në një ndërmarrje publike, kur zyrtarja që paraqitej si përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun, pas një debati të mëparshëm verbal me gazetarët, i mori telefonin njërit prej tyre dhe refuzoi t'ia kthente.<sup>143</sup> Në të njëjtën kohë, tre anëtarë të sigurimit nga sipërmarrja, kundër vullnetit të dy gazetarëve, i mbajtën ata në mjediset e institucionit dhe ata u liruan vetëm pas mbërritjes së oficerëve të MPB-së, të cilët erdhën menjëherë pasi incidenti u raportua nga një prej gazetarëve.<sup>144</sup>

## Të drejtat e fëmijës

Kah fundi i gushtit, dy punëtorë konsultative u mbajtën në kuadër të iniciativës 'Drejtësia për fëmijë - BE për drejtësi për të mitur sipas fëmijëve', të cilën UNICEF e zbaton me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian, Shkup, lidhur me domosdoshmërinë e mbledhjes dhe menaxhimit efikas dhe efektiv të të dhënave për drejtësinë për fëmijë, si dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët viktime dhe dëshmitarë nën një çati, në mënyrë që të marrin mbrojtje dhe trajtim adekuat.<sup>145</sup>

Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve miratoi një Strategji të re Kombëtare për Parandalim dhe Drejtësi për Fëmijët për periudhën shtator 2022 - qershor 2027; Strategjia u zhvillua me mbështetjen e ekspertëve të ofruar nga UNICEF dhe BE. Strategjia Kombëtare përmban disa qëllime strategjike në lidhje me viktimat fëmijë dhe dëshmitarët fëmijë.<sup>146</sup>

141 'SHGM: Ekipi i Gazetarëve të Alsat ndalohet nga gjirimi në Saraj (Новинарска екипа на Алсат спречена да снима во Сарај)', *Radio MOF*, 4 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/znm-novinarska-ekipa-na-alsat-sprechena-da-snima-vo-saraj/>.

142 'SHGM kërkoi përgjegjësi për policët që ngacmuan gazetaren Viki Klincharova (ЗНМ бара одговорност за полицајците кои ја вознемирувале новинарката Вики Клинчарова)', *Radio MOF*, 12 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/znm-bara-odgovornost-za-policaјcite-koi-ja-voznemiruvale-novinarkata-viki-klincharova/>.

143 "Sulmohet ekuipazhi i TV Klan në ndërmarrjen publike të higjienës komunale (Нападната екипата на ТВ Клан во Комунална Хигиена)," *24info.Mk*, 8 gusht 2022, [shorturl.at/acr37](https://www.24info.mk/acr37).

144 SHGM dënoi veprimet e punonjësve të institucionit dhe kërkoi nga MPB të hetojë menjëherë rastin dhe të informojë publikun për këtë veprim të paprekshëm ndaj gazetarëve dhe kërkoi nga drejtori i institucionit të hetojë urgjentisht, si dhe të nisë masa disiplinore në kuadër të kompetencave të saj ligjore. Më pas, ndërmarrja publike njoftoi se kishte filluar një procedurë disiplinore ndaj punonjësit që shkaktoi incidentin, duke deklaruar se ndërmarrja është e hapur dhe transparente për të gjithë qytetarët dhe mediat dhe në të ardhmen nuk do të lejohet asnjë sjellje e pahijshme ose e papërshtatshme në ndërmarrjen. Së fundi, edhe Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale reagoi ndaj këtij incidenti, duke deklaruar se të gjithë duhet të sillen në mënyrë të denjë dhe me dinjitet, veçanërisht gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës dhe se institucionet publike duhet të jenë të hapura dhe transparente dhe të bëjnë çdo përpjekje për t'u siguruar përfaqësuesve të mediave qasje të papenguar në informacion kur raportojnë për tema që janë me interes publik.

145 UNICEF MK, 'Dy punëtorë konsultative u mbajtën në kuadër të nismës "Drejtësia për fëmijë - BE për drejtësinë e të miturve sipas fëmijëve", të cilën UNICEF e zbaton me mbështetjen e delegacionit të Bashkimit Evropian, Shkup (Во изминатите два дена се одржаа две важни, консултативни работилници во рамките на иницијативата „Правда за деца - ЕУ за малолетничка правда по мерка на децата“ која УНИЦЕФ ја спроведува со поддршка од Делегацијата на Европска унија, Скопје)', 24 gusht 2022, <https://www.facebook.com/unicef.mk/posts/pfbid02uDWsGo9U4zmsuyh3VwBcWei1zy8XkPNkatDA1TzsoUYBtuxHTrnBFYjqR6jAoDLXI>.

146 'Promovimi i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët (2022-2027) (Промоција на Националната стратегија за превенција и правда за децата (2022-2027)', *Faqja zyrtare e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikucencës së të Miturve*, 15 shtator 2022, <https://dspdp.com.mk/vesti/promocija-na-nacionalnata-strategija-za-prevencija-i-pravda-za-decata-2022-2027/>.

Ministria për Punë dhe Politikë Sociale (MPPS) përditësoi protokollin ndër-sektorial për trajtimin e fëmijëve në rrugë në shtator 2022.<sup>147</sup> Qëllimi i protokollit është të përmirësojë mënyrën e trajtimit të fëmijëve në rrugë, përmes një qasjeje të unifikuar, multidisiplinare dhe ndërsektoriale, në mënyrë që të sigurojë ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje të fëmijëve dhe përfshirjen e tyre në shoqëri për realizimin e interesave më të mira të fëmijës.<sup>148</sup>

## Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit

Në periudhën raportuese, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) mori 59 ankesa dhe hapi një rast me iniciativën e vet. Gjatë kësaj periudhe janë marrë gjithsej 56 vendime dhe në 15 prej tyre janë konstatuar diskriminime në bazë të orientimit seksual (katër raste), identitetit gjinor (katër raste), personalitetit dhe statusit social (katër raste) dhe kombësisë apo etnicitetit (tre raste).<sup>149</sup>

Koalicioni 'Ne Ndryshojmë' njoftoi se do t'i dërgojë kërkesa delegacionit të BE, UNICEF, OSBE, OKB dhe trupit diplomatik në vend për mbështetje dhe ndërmjetësim në realizimin e të drejtave për barazi, një jetë të dinjitetshme dhe për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përgjithshme publike. Koalicioni po kërkon një rritje prej 35 përqind në pagesën e aftësisë së kufizuar dhe që kufiri i moshës për përfitimin e të drejtave të aftësisë së kufizuar të ulet nga 26 në 18 vjet, që të krijohet një regjistër i personave me aftësi të kufizuar dhe që ndihma për fëmijët dhe personat me shikim të dëmtuar, pajisjet për matjen e sheqerit në gjak dhe pajisjet për matjen e presionit të gjakut dhe termometrat të paguhen nga shteti.<sup>150</sup> MPPS informoi publikun se do t'i adresojë këto çështje me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, një ndryshim në Ligjin për Mbrojtjen Sociale dhe Strategjinë e re Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2022-2027.<sup>151</sup> Kryeministri konfirmoi se Qeveria ka bërë reforma si askush tjetër më parë dhe ka rritur buxhetet në sferën sociale. Ata kanë inkuadruar programe dhe aktivitete që ofrojnë mbështetje për njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe të gjithë ata që kanë nevojë për mbështetje më të madhe nga shteti.<sup>152</sup>

Drejt fundit të korrikut, KPMĐ dhe Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi me qëllim ndërmarrjen e aktiviteteve të koordinuara për të promovuar mbrojtjen kundër diskriminimit dhe për të siguruar gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.<sup>153</sup>

147 'Protokolli Ndërsektorial për Trajtimin e Fëmijëve në Rrugë (Меѓусекторски протокол за постапување со деца на улица)' (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (Министерство за труд и социјална политика), shtator 2022), <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/protokol.doc>.

148 Ibid.

149 Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Paraqitja e Informacionit Publik (Доставување на информации од јавен карактер)", 20 tetor 2022.

150 'Shteti ka një vit që ka gënjyer njerëzit me aftësi të kufizuara dhe nuk realizon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, sotë Koalicioni "Ne ndryshojmë" dhe ata kërkojnë ndihmë nga BE (Државата една година ги лаже и не ги остварува правата на лицата со попреченост, велат од Коалицијата „Менуваме“ и бараат помош од ЕУ)', *Sdk.Mk*, 27 korrik 2022, <https://sdk.mk/index.php/dopisna-mrezha/drzhavata-edna-godina-gi-lazhe-i-ne-gi-ostvaruva-pravata-na-litsata-so-poprechenost-velat-od-koalitsijata-menuvame-i-baraat-pomosh-od-eu/>.

151 'MPPS: Po ndërtojme një sistem që është i drejtë dhe i përshtatur për njerëzit me aftësi të kufizuara (МТСП: Градиме систем кој е праведен и прилагоден на лицата со попреченост)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 28 korrik 2022, <https://vlada.mk/node/29717>.

152 'Kovačevski: Ne ofrojmë mundësi të barabarta për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe në rrezik social, me më shumë burime, kujdes dhe shërbime cilësore (Ковачевски: Обезбедуваме еднакви можности за лицата со попреченост и во социјален ризик, со повеќе средства, грижа и квалитетни услуги)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 28 korrik 2022, <https://vlada.mk/node/29725>.

153 'KPMĐ dhe Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi (КСЗД и Кабинетот на претседателот на РС Македонија потпишаа Меморандум за соработка)', *Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, 25 korrik 2022, <https://bit.ly/3DeVeq5>.

Zëvendëskryeministri vazhdoi të mbështesë grupet e cenueshme sociale dhe të marginalizuara, të cilat dëshirojnë të bëjnë një ndryshim pozitiv përmes angazhimit në punë, duke mbështetur revistën 'Lice v Lice' ('Ballë për ballë'), e cila angazhon njerëz nga grupet e marginalizuara dhe të cenueshme të shoqërisë. Me këtë rast, Zëvendëskryeministri deklaroi se përfshirja e grupeve të marginalizuara dhe të cenueshme në shoqëri është një vlerë evropiane që duhet ta ndajmë dhe se është e rëndësishme të sigurojmë mbështetje për grupet e cenueshme, veçanërisht për fuqizimin e tyre ekonomik dhe se aftësimi i tyre për një jetë të dinjitetshme është detyrë e Qeverisë.<sup>154</sup>

Në fund të gushtit, KPMD njoftoi se do të fillojnë procedura kundërvajtëse kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për shkak të diskriminimit të tërthortë të vendosur në lidhje me njoftimin nga MASH për rritjen e bursave për studentë dhe nxënës deri në 80 përqind, e cila nuk do të zbatohet për të gjithë studentët dhe nxënësit, domethënë, shumat më të larta do të merren vetëm nga ata që kanë aplikuar në thirrjet e reja të MASH-it për aplikime për bursa, ndërsa pjesa tjetër që ka ushtruar të drejtën për bursë në vitet e mëparshme do të vazhdojë të marrë shumat më të ulëta të mëparshme.<sup>155</sup>

Gjykata Themelore Civile në Shkup përcaktoi se Qeveria dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kishin kryer diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së tyre të votës duke mos ndërmarrë veprime për të përshtatur infrastrukturën dhe hapësirën në dhe në një pjesë të qendrave të votimit, dhe kishin shkelur parimin e përshtatjes së duhur. Në këtë mënyrë, të pandehurit e kanë bërë të pamundur për personat me aftësi të kufizuara të ushtrorjnë të drejtën e tyre të votës, duke penguar kështu pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në jetën politike të shtetit. Gjykata urdhëroi Qeverinë dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve që, deri në shpalljen e zgjedhjeve të ardhshme, të sigurojnë kushte të përshtatshme brenda qendrave të votimit ku deri tani nuk ka qenë kështu, të lejojnë personat me aftësi të kufizuara të ushtrorjnë të drejtën e tyre të votës. Gjykata themelore civile e dha këtë vendim pasi Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (HCHR) ngriti një padi për mbrojtje kundër diskriminimit në interes publik (actio popularis) më 1 shkurt 2021.<sup>156</sup>

KPMD përcaktoi ngacmimin e bazuar në paaftësi të kryer nga drejtori i Qendrës për Menaxhimin e Krizave në një deklaratë të dhënë në televizion. Kështu, KPMD rekomandoi që drejtori të lëshojë një falje publike për personat me aftësi të kufizuara ndaj të cilëve drejtori veproi brenda afatit të dhënë dhe paraqiti një falje publike për personat me aftësi të kufizuara.<sup>157</sup>

Në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, HCHR deklaroi se përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor është një proces i lënë pas dore, duke shkaktuar dëme të mëdha për fëmijët dhe prindërit e tyre. Megjithatë arsimi i mesëm është i detyrueshëm, edhe ky vit shkollor filloi pa asistentë arsimorë në shkollat e mesme. Ndryshimet përkatëse ligjore nuk janë miratuar dhe as nuk dihet se kur do të miratohen dhe të hyjnë në fuqi. Megjithatë, mungesa e vullnetit politik për t'u marrë me këtë problem mund të shihet

154 'Zëvendëskryeministri Mariçiq vazhdon të mbështesë grupet e cenueshme shoqërore (Вицепремиерот Мариќиќ продолжува со поддршка на социјално ранливите групи)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 29 gusht 2022, <https://vlada.mk/node/29956>.

155 'KPMD shpalli një Raport të Kundërvajtjes kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për Bursa të Pabarabarta (КСЗД најави прекршочна пријава против МОН за неизедначените стипендии)', *Radio MOF*, 30 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/kszd-na-javi-prekrshochna-prijava-protiv-mon-za-neizednachenite-stipendii/>.

156 'Qeveria dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kanë kryer diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre të votës (Владата и Државната изборна комисија сториле директна дискриминација врз лицата со попреченост при остварување на нивното право на глас)', *Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë*, 1 shtator 2022, <https://bitly/3f7WWmb>.

157 'Ngacmim i identifikuar i Personave me Aftësi të Kufizuara nga Drejtori i Qendrës së Menaxhimit të Krizave (Утврдено вознемирување врз лицата со попреченост од страна на директорот на Центарот за управување со кризи)', *Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, 14 shtator 2022, <https://bit.ly/3TGNFQO>.

në faktin se MASH nuk e di as numrin e saktë të nxënësve të shkollave të mesme që do të kishin nevojë për asistentë arsimorë. Kjo tregon se përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si grupi më i cenueshëm në shoqëri, nuk është ndër prioritetet e institucioneve kompetente.<sup>158</sup>

Në mes të shtatorit, u prezantua botimi i 'Standardeve të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen dhe Parandalimin e Diskriminimit mbi Bazat e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinator', duke përcaktuar kështu se ka përparim në këtë fushë në shoqërinë tonë, por ajo është e fragmentuar, e ngadaltë dhe ndonjëherë edhe në rrezik për të shkuar prapa.<sup>159</sup>

Opinionin e Komitetit Këshillor të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare deklaroi se Maqedonia e Veriut ka arritur përparim të rëndësishëm në mbrojtjen ligjore të të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, veçanërisht në fushën e anti-diskriminimit dhe përdorimit e gjuhës shqipe. Ai shtoi se në nivelin politik, strategjia 'Një shoqëri për të gjithë' ofron një plan udhëzues të vlefshëm drejt një shoqërie të integruar shumë-etnike dhe është në përputhje me parimet e Konventës Kornizë?? pasi nxit respektin për diversitetin nëpërmjet dialogut ndër-kulturor. Megjithatë, zbatimi praktik i legjislacionit dhe politikave për pakicat kombëtare duhet të përmirësohet.<sup>160</sup>

## Gjinia

Në fillim të korrikut, OJQ HERA njoftoi se katër zyra të reja gjinekologjike janë hapur në qendrat shëndetësore në katër qytete maqedonase: Makedonski Brod, Resen, Radovish dhe Delçevë. Klinikat janë rezultat i bashkëpunimit midis HERA dhe Qendrës për Mjekësi Familjare me Mbështetjen e Shëndetit Publik, dhe klinikat e reja do të ofrojnë shërbime shëndetësore riprodhuese falas për gratë në moshë riprodhuese nga këto rajone, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe gratë nga zonat rurale.<sup>161</sup>

Buxhetimi gjinor ndikon drejtpërdrejt në avancimin e barazisë gjinore në vend. Megjithëse buxhetimi gjinor në Maqedoninë e Veriut përcaktohet përmes Ligjit për Mundësi të Barabarta, dhe strategjia për futjen e buxhetimit gjinor si dokument kombëtar ka ekzistuar që nga viti 2012, buxhetimi gjinor ende nuk është rregulluar në Ligjin për Buxhetet. Raporti Përfundimtar i ESHR për një auditim të suksesshëm të kryer 'Efektiviteti i masave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Barazinë Gjinore dhe Iniciativat e përshtatshme të Buxhetit Gjinator' tregoi se Ligji për Buxhetet nuk përcakton termat "pasqyra/iniciativa e buxhetit gjinor", "treguesit gjinorë" dhe "qëllimet gjinore", duke e bërë kështu të pamundur kryerjen e një analize gjinore të programeve dhe nënprogrameve buxhetore. Raporti tregoi se masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë të mjaftueshme për të siguruar krijimin efektiv të konceptit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në proceset e krijimit dhe zbatimit të politikave. I njëjti konkluzion është dhënë edhe për proceset e monitorimit të arritjes së objektivave të

158 'Papërgjegjësia e autoriteteve minon përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara (Неодговорноста на надлежните ја минира инклузијата на децата со попреченост)', *Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë*, 6 shtator 2022, <https://mhc.org.mk/news/neodgovornosta-na-nadlezhnite-ja-minira-inkluzijata-na-decata-so-poprechenost/>.

159 'Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor është i papërputhshëm me standardet e Këshillit të Evropës (Дискриминацијата врз основа на сексуална ориентација или родов идентитет е некомпатибилна со стандардите на Советотот на Европа)', *Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë*, 16 shtator 2022, <https://mhc.org.mk/news/diskriminacijata-vrz-osnova-na-seksualna-orientacija-ili-rodov-identitet-e-nekompatibilna-so-standardite-na-sovetot-na-evropa/>.

160 'Maqedonia e Veriut ka bërë përparim të rëndësishëm në mbrojtjen ligjore të pakicave (С. Македонија постигна значителен напредок во правната заштита на малцинствата)', *Radio MOF*, 21 shtator 2022, <https://www.radiomof.mk/s-makedonija-postigna-znachitel-en-napredok-vo-pravnata-zashtita-na-malcinstvata/>.

161 'HERA: Katër zyra të reja gjinekologjike u hapën në Makedonski Brod, Resen, Radovish dhe Delçevë (ХЕРА: Отворени Четири Нови Гинеколошки Ординации Во Македонски Брод, Ресен, Радовиш и Делчево)', *Radio MOF*, 4 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/hera-otvoreni-chetiri-novi-ginekoloski-ordinacii-vo-makedonski-brod-resen-radovish-i-delchevo/>.

buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të krijimit të politikave: identifikimi dhe vlerësimi i problemit, buxheti, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi dhe arritja e objektivave të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2020 – 2030.<sup>162</sup>

Megjithatë, një hap në drejtimin e duhur u ndërmor në fund të korrikut, kur u miratua Strategjia për Barazinë Gjinore 2022-2027, duke krijuar kështu një kornizë gjithëpërfshirëse për aktivitete të mëtejshme në drejtim të promovimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Me miratimin e kësaj Strategjie, Republika e Maqedonisë së Veriut përpiqet të përmirësojë gjendjen e barazisë gjinore në përputhje me standardet, rekomandimet dhe detyrimet ndërkombëtare, duke pranuar se barazia gjinore është një nga aspektet kryesore që ndikon në prosperitetin e të gjithë shoqërisë. Për më tepër, me miratimin e ndryshimeve në Propozim-ligjin për Buxhetin, është e besueshme përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetet e organeve të administratës shtetërore, duke bërë që buxhetet të bëhen gjinore dhe t'u përgjigjen nevojave të të gjithë qytetarëve.<sup>163</sup>

Në një panel diskutimi të organizuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (HCHR) brenda projektit 'Parandalimi, mbështetja dhe avokimi për dhunën me bazë gjinore' në mes të korrikut, u vërtetua se gjatë vitit 2021, nga 33 raste të dhunës me bazë gjinore, 26 ishin viktime të dhunës familjare, dy të dhunës seksuale, tre të përdhunimit dhe dy të ngacmimit seksual. Sipas HCHR-së, këto raste tregojnë joprofesionalizëm, kontradikta dhe mospërputhje në veprimet e disa qendrave të punës sociale, si dhe mosveprim institucional në rastet e dhunës së ushtruar nga një ish-partner, mosveprim nga PP pas një kallëzimi penal për dhunë me bazë gjinore, dhe mosveprim nga MPB pas raportimeve për dhunë në familje.<sup>164</sup>

Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje bëri një deklaratë publike pas ngjarjeve të fundit të dhunës në familje që ndodhën në Gostivar<sup>165</sup> <sup>166</sup>, Negotino<sup>167</sup> <sup>168</sup> dhe

162 Enti Shtetror i Revizionit, 'Raporti përfundimtar për revizionin e performancës' 'Efektiviteti i masave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për barazinë gjinore dhe iniciativat e duhura të buxhetit gjinor' '(Конечен извештај за извршена ревизија на успешност „Ефективност на мерките на Владата на Република Северна Македонија за родова еднаквост и соодветни родови буџетски иницијативи“), 1 korrik 2022 [https://dzr.mk/sites/default/files/2022-07/RU\\_Efektivnost\\_merki\\_Vlada\\_rodova\\_ednakvost\\_0.pdf](https://dzr.mk/sites/default/files/2022-07/RU_Efektivnost_merki_Vlada_rodova_ednakvost_0.pdf).

163 'MPPS: Miratohet Strategjia për Barazi Gjinore 2022-2027 (МТСП: Изгласана Стратегијата за родова еднаквост 2022-2027 година)', *Faqja zyrtare e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale*, 27 korrik 2022, [https://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns\\_article-mtsp-izglasana-strategijata-za-rodova-ednakvost-2022-2027-godina.nspix](https://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-mtsp-izglasana-strategijata-za-rodova-ednakvost-2022-2027-godina.nspix).

164 'Komiteti i Helsinkit: Trajtimi joprofesional i 33 rasteve të dhunës me bazë gjinore në vitin 2021 (Хелсиншки: Непрофесионално постапување по 33 случаи на родово-базирано насилство во 2021)', *Radio MOF*, 13 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/helsinki-neprofesionalno-postapuvanje-po-33-sluchai-na-rodovo-bazirano-nasilstvo-vo-2021/>.

165 Një grua nga Gostivari, e moshës 27 vjeçare, nënë e një fëmije të vogël, u përball dhe pësoi dhunë në familje nga ish partneri i saj për pesë vjet, pavarësisht se e raportoi atë në institucionet kompetente. Ekzistojnë gjashtë procedura penale aktive kundër dhunuesit, i cili është gjithashtu një oficer policie, por rruga drejt drejtësisë për viktimën ka qenë e pasuksesshme, për shkak të vendimit të ndërgjegjshëm të gjykatës për të mbrojtur dhunuesin, dhe jo viktimën dhe familjen e saj, të cilët jetojnë nën stres dhe frikë për jetën e tyre çdo ditë. Ndërsa Gjykata Themelore në Gostivar ka dhënë dënime të lehta që janë të papërshtatshme për krimet e kryera, një çështje tjetër mbetet se të njëjtat aktgjykime në mënyrë të përsëritur rrezohen nga Gjykata e Apelit të Gostivarit, dhe kështu dhunuesi mbetet i pandëshkuar, duke kontribuar në viktimizimin sekondar për ata që raportojnë dhunë në familje.

166 'Gjykata e Apelit në Gostivar do të nxjerrë me urgjencë një vendim gjyqësor që do të mbrojë Elena Jovicoskën dhe do të dënojë autorin e dhunës në familje (Апелациониот суд Гостивар итно да донесе судска пресуда со која ќе ја заштити Елена Јовицоска и ќе го осуди сторителот на семејно насилство.)', *Faqja zyrtare e Rrjetit Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, 5 gusht, 2022, <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/apelatsioniot-sud-gostivar-itno-da-donese-sudska-presuda-so-koja-ke-ja-zashtiti-elena-jovit-soska-i-ke-go-osudi-storitelot-na-semejno-nasilstvo/>.

167 Pas një grindjeje verbale, një burrë që jetonte në një bashkim jashtëmartesor për disa vjet me një grua nga Negotino, kreu dhunë në familje kundër saj, duke e goditur atë në mënyrë të përsëritur në kokë dhe pastaj duke e shtyrë atë drejt dushit të banjës. Viktima ra dhe pësoi një dëmtim të rëndë trupor nga i cili ra në gjendje kome dhe si pasojë vdiq.

168 'Gruaja që u rrah nga burri në Negotino me të cilin ajo ishte në një bashkim jashtëmartesor ka vdekur, ai do të ndiqet penalisht për një krim të rëndë (Почина жената претепана од неготинецот со кој била во вонбрачна заедница, тој ќе се гони за потешко кривично дело)', 7 gusht 2022, <https://www.slobodenpecat.mk/pochina-zhenata-pretepana-od-negotinecot-so-koj-bila-vo-vonbrachna-zaednica-toj-ke-se-goni-za-poteskho-krivichno-delo/>.

Strumicë<sup>169</sup> 170, të cilat ngritën pyetjen se sa mirë i mbron shteti gratë që përballojnë dhunën familjare dhe me bazë gjinore në baza ditore. Sipas Rrjetit, i gjithë sistemi për parandalimin e dhunës është krejtësisht i paefektshëm, gjë që duket se vë në pikëpyetje serioze qëllimin e Konventës së Stambollit dhe Ligjit mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje. Femicidi i një gruaje 46-vjeçare nga Negotino shton statistikën ngacmuese sipas të cilave më shumë se 80% e viktimave në vend nuk kanë raportuar më parë dhunë në institucionet kompetente.<sup>171</sup>

Në muajin shtator, u shfaqën raste të reja të dhunës së raportuar në familje, duke bërë që Prokuroria Themelore Publike e Gjevgjeliës të fillojë procedurë për vepër penale, lëndim trupor dhe vepër penale. Mosekzekutimi i një vendimi gjyqësor për një person që dëmton ish-partnerin e tij jashtëmartesor dhe nuk i përmbahet një vendimi gjyqësor të mëparshëm, i cili përcakton ndalimin e kontaktit dhe afrimit me ish-partnerin e tij.<sup>172</sup> Shpejt pas këtij rasti, një rast i ngjashëm u shfaq në Manastir, ku duke vepruar në një ankesë të dorëzuar penale, Prokuroria Themelore Publike në Manastir filloi një procedurë kundër një personi të dyshuar se ka rrezikuar sigurinë e ish-bashkëshortes së tij, duke mos iu përmbajtur ndalimit për të kontaktuar dhe për t'iu afruar ish-partnerit të tyre.<sup>173</sup>

Më 20 shtator, propozim-ligji për Barazi Gjinore u publikua në ENER. Qëllimi i ligjit, sipas MPPS-së, është të sigurojë realizimin e barazisë së plotë gjinore në të gjitha sferat e jetës publike dhe private duke forcuar pozitën dhe statusin e grave në shoqëri dhe duke siguruar mundësi të barabarta për realizimin e të gjitha të drejtave përmes promovimit të barazisë gjinore.<sup>174</sup>

KPMD lëshoi një mendim për vendosjen e ngacmimit seksual në një episod të një shfaqjeje, përmes objektizimit seksual të pamjes së një vajze, dhe pritësi i shfaqjes nuk veprroi mbi pretendimet e peticionit brenda periudhës së përcaktuar ligjore, kështu që KPMD bëri një rekomandim që episodi specifik të hiqet dhe të jepet një falje publike, si dhe të mos paraqesë përmbajtje që prodhon ngacmim në të ardhmen.<sup>175</sup>

169 Një burrë 35 vjeçar nga Strumica u arrestua për dhunë në familje pasi sulmoi gruan e tij me një objekt të mprehtë dhe plagosi djalin e tyre të vogël.

170 'Një burrë nga Strumica sulmoi gruan e tij me një objekt të mprehtë, gjithashtu plagosi fëmijën e tyre të ri (Струмичанец со оstar предмет ја нападнал сопругата, го повреди и малолетното дете)', *Faktor.Mk*, 7 gusht 2022, <https://faktor.mk/strumichanec-ja-napadnal-soprugata-so-ostar-predmet-go-povredil-i-maloletnoto-dete>.

171 'Femicidet janë produkt i heshtjes së shoqërisë dhe i mosfunksionimit të saj në institucione (Фемидците се производ на молкот на општеството и недовербата во институциите)', *Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë*, 8 gusht 2022, [https://mhc.org.mk/news/femicidite-se-proizvod-na-molkot-na-opshtestvoto-i-nedoverbata-vo-instituciite/fbclid=Iw2WJSU2\\_yybloiClmClScLNSIAjAjvoj2QVVV8GThSQQi&clsi=cl](https://mhc.org.mk/news/femicidite-se-proizvod-na-molkot-na-opshtestvoto-i-nedoverbata-vo-instituciite/fbclid=Iw2WJSU2_yybloiClmClScLNSIAjAjvoj2QVVV8GThSQQi&clsi=cl).

172 'Procedura për lëndime trupore gjatë dhunës në familje në Gjevgjeli (Постапка за телесна повреда при семејно насилство во Гевгелија)', *Pravdiko*, 7 shtator 2022, <https://www.pravdiko.mk/postapka-za-telesna-povreda-pri-semejno-nasilstvo-vo-gevgelija/>.

173 'РТРП Манастир ме një Procedurë për Rrezikimin e Sigurisë në Rastin e Dhunës në Familje (ОЈО Битола со постапка за загрозување на сигурноста при семејно насилство)', *Pravdiko*, 9 shtator 2022, <https://www.pravdiko.mk/ojo-bitola-so-postapka-za-zagrozuvane-na-sigurnosta-pri-semejno-nasilstvo/>.

174 'Barazia dhe eliminimi i stereotipeve – Po përgatitet një ligj i ri për barazinë gjinore (Еднаквост и елиминирање на стереотипите – во подготовка нов Закон за родова еднаквост', *Akademik*, 20 shtator 2022, <https://akademik.mk/ednakvost-i-eliminirane-na-stereotipite-vo-podgotovka-nov-zakon-za-rodova-ednakvost/>.

175 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë, "Në qershor 2022, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në emër të një vajze që kërkoi ndihmë ligjore, dorëzoi një ankesë në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër Sergej Varoshlija për Ngacmimin Seksual të Bazuar në Gjininë në Fushën e Informimit Publik dhe Medias. (Хелсиншкиот комитет за човекови права во јуни 2022 година, во име на девојка која побара правна помош, поднесе претставка до Комисија за спречување и заштита од дискриминација против Сергеј Варошлија за сторено сексуално вознемирување врз основа на пол и род во областа на јавно информирање и медиуми)", 22 shtator 2022, [https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=pfbid02HcUCu1tkfpaRrQi9G5WbmEaGyWQUhN9L8m6WqmSzAbrxmmNJtwSyUpFeViqGNbl&id=379156826110](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02HcUCu1tkfpaRrQi9G5WbmEaGyWQUhN9L8m6WqmSzAbrxmmNJtwSyUpFeViqGNbl&id=379156826110).

## Gjuha e urrejtjes

Kohët e fundit, u bënë ndryshime në Kodin Penal dhe aktit të 'urrejtjes në bazë të një ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar' iu shtuan krimet e urrejtjes, sipas luftës kundër gjuhës së urrejtjes që është vendosur midis segmenteve kryesore të protokollit dypalësh të nënshkruar kohët e fundit nga Shkupi dhe Sofia. Gjuha e urrejtjes nuk do të jetë nën kompetencën e diplomacisë, por vetëm institucionet kompetente do të vlerësojnë se çfarë konsiderohet gjuhë e urrejtjes dhe në raste të tilla, do të veprojnë sipas ligjit, dhe kjo nuk duhet të lidhet vetëm me Bullgarinë, siç shpjegohet nga Ministri për Punët e Jashtme dhe Ministri për Drejtësi.<sup>176</sup>

HCHR shprehu shqetësimin e saj se festimi shtetëror i përvjetorit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit i organizuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vend që të kishte karakter unifikues, ishte një rast tjetër për përhapjen e urrejtjes dhe intolerancës ndër-etnike. Njoftimi i prezantuesit në gjuhën maqedonase, i cili u mirëprit nga të pranishmit, kundërshtoi drejtpërdrejt idenë e një festivali multikulturor dhe shkaktoi urrejtje midis komuniteteve etnike në vend.<sup>177</sup>

## LGBTI +

Në mes të korrikut, një stol shumëngjyrësh në një oborr shkollë në Stojakovë, që i ngjante ngjyrave të ylberit, shkaktoi gjuhë urrejtjeje në internet dhe kërkesa që stoli të ngjyroset menjëherë me një ngjyrë tjetër, pas së cilës një person i quajtur "Presidenti i komunitetit LGBT nga Stojakovë" u akuzua për lyerjen e stolit, duke u bërë kështu shënjestra e urrejtjes në internet dhe thirrjeve për rrahje. Drejtori i shkollës konfirmoi se ky person nuk ishte në asnjë mënyrë i lidhur me stolin 'problematic' pasi ai ishte pikturuar si pjesë e një rinovimi të oborrit të shkollës që u bë në dhjetor 2021 dhe në asnjë mënyrë nuk kishte për qëllim të provokonte publikun e gjerë.<sup>178</sup>

Sulmet kundër presidentit të 'LGBTI United' vazhdojnë, dhe Rrjeti Kombëtar Kundër Homofobisë dhe Transfobisë dënoi sulmin e fundit dhe u kërkoi institucioneve kompetente të konfirmojnë urgjentisht identitetin dhe të sanksionojnë autorin e, siç thonë, këtij akti të urrejtjes.<sup>179</sup> Pas akteve të përsëritura të dhunës të kryera kundër tij, presidenti i 'LGBTI United' mbajti një konferencë shtypi para Qeverisë, duke u bërë thirrje institucioneve të veprojnë urgjentisht për të identifikuar përgjegjësit për sulmet fizike për të cilat ai ishte viktimë dhe nëse kjo nuk ndodh, ai deklaroi se do të kampoje brenda ndërtesës së Qeverisë, pasi ai nuk ndihet i sigurt çdo herë që del.<sup>180</sup>

176 'Gjuha e urrejtjes do të gjykohe vetëm në format më të rënda (Говорот на омраза ќе се суди само при најтешките форми)', *Sloboden Pecat*, 26 korrik 2022, <https://www.slobodenpecat.mk/govorot-na-omraza-kje-se-sudi-samo-pri-najteshkite-formi/>.

177 'Kërkojmë dënim publik të përhapjes së urrejtjes ndër-etnike (Бараме јавна осуда за ширењето меѓуетничка омраза)', *Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë*, 17 gusht 2022, <https://mhc.org.mk/news/barame-javna-osuda-za-shirenjeto-meguetnichka-omraza/>.

178 'Një bankë shkollore shumëngjyrëshe në Stojakovë shkaktoi fyerje për një aktivist LGBTI + (Училишна шарена клупа во Стојаково предизвика навреди кон ЛГБТИ + активист)', *Radio MOF*, 13 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/uchilishna-sharena-klupa-vo-stojakovo-predizvika-navredi-kon-lgbti-aktivist/>.

179 'Aktivistët kërkojnë reagim të menjëhershëm ndaj sulmit të Asanit nga "LGBTI United" (Активистите бараат итна реакција за нападот на Асани од „ЛГБТИ унајтед“)', *Radio MOF*, 10 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/aktivistite-baraat-itna-reakcija-za-napadot-na-asani-od-lgbti-junajted/>.

180 'Nëse nuk ndëshkohen njerëzit që më sulmuan, unë do të ngre një çadër në qeveri për të qenë i sigurt, thotë aktivisti i LGBTI-së Asani (Ако не се казнат луѓето кои ме нападнаа ќе поставам шатор во Владата за да бидам безбеден, вели ЛГБТИ активистот Асани)', *Radio MOF*, 12 shtator 2022, <https://www.radiomof.mk/ako-ne-se-kaznat-lugjeto-koi-me-napadnaa-kje-postavam-shator-vo-vladata-za-da-bidam-bezbeden-veli-lgbti-aktivistot-asani/>.



Pjesa e dytë e fundjavës së krenarisë në Shkup, u mbajt nga 15 deri në 17 shtator dhe tema kryesore e festivalit të këtij viti për kulturën, artin dhe teorinë queer, qëllimi i të cilit ishte të krijonte një hapësirë për paraqitjen dhe nxitjen e formave jo-normative të botëkuptimit.. Tema trajton marrëdhëniet, pozicionet e identitetit, stilet e trupit dhe ndjeshmëritë e shënuara nga kontekstet heteronormative, nacionaliste dhe neoliberal kapitaliste si queer, ekscentrike dhe të dështuara.<sup>181</sup>

## Romët

Shoqata 'Nisma për të Drejtat e Grave nga Shuto Orizari' informoi se një vajzë e re nga komuniteti rom u përball me diskriminim të drejtpërdrejtë interseksional bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, përkatësinë kombëtare e etnike, duke u ndaluar që të përdorte një pishinë në ditë të caktuara. Sektori i Policisë së Shuto Orizarit iu përgjigj kësaj duke pretenduar se nuk është diskriminim. Shoqata, së bashku me OJQ-në HERA, dorëzoi një peticion në KPMD dhe tek Avokati i popullit.<sup>182</sup>

KPMD ka lëshuar një opinion kundër një shkolle fillore në Manastir, ku autoritetet kanë një afat kohor prej gjashtë muajsh për të zbatuar masat për të reduktuar ndarjen e fëmijëve romë në shkollë, gjë që bëhet nëpërmjet praktikave të regjistrimit në shkollë që përbëjnë diskriminim të tërthortë ndaj fëmijëve romë që janë ndarë në bazë të etnisë së tyre, gjë që është në kundërshtim me ligjin mbi arsimin bazë. Përkatësisht, prindërit e nxënësve jo-romë u mundësuan të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkolla jashtë mjedisit ku jetojnë për shkak të zbatimit selektiv të ligjit nga shkolla. Kjo do të thotë se shkolla u bë de facto e ndarë etnikisht pasi një numër i madh fëmijësh jo-romë u lejua të transferohen në shkolla në zona të tjera, duke bërë që KPMD të rekomandojë drejtorët e shkollave në këtë fushë të regjistrojnë vetëm ata fëmijë që administrativisht i përkasin asaj shkolle, ndërsa MASH u udhëzua të vendosë kritere më të rrepta për regjistrimin e fëmijëve në një shkollë që është jashtë rajonit të tyre.<sup>183</sup>

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR) njoftoi se autoritetet lokale në Komunën e Prilepit morën një urdhër për të siguruar qasje në ujë të pastër në dy vendbanimet rome në Prilep, pas një peticioni të paraqitur nga QEDR, si dhe një vendim nga KPMD për diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, etninë, origjinën sociale dhe statusin e pronës në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, pasi këto vendbanime rome nuk kanë qenë kurrë të lidhura me ujësjellësin kryesor, pavarësisht nga fakti se komunitetet rome kanë jetuar atje për një kohë të gjatë.<sup>184</sup>

181 'Pjesa e dytë e fundjavës së krenarisë së Shkupit në disa lokacione nga 15 deri më 17 shtator (Вториот дел од викендот на гордоста Скопје на неколку локации од 15 до 17 септември)', *Radio MOF*, 11 shtator 2022, <https://www.radiomof.mk/vtoriot-del-od-vikendot-na-gordosta-skopje-na-nekolku-lokacii-od-15-do-17-septemvri/>.

182 'Diskriminimi i raportuar – "A e keni ditur se romët kanë të drejtë të notojnë në pishinë vetëm një ditë në javë?" (Пријавена дискриминација – „Знаевте ли дека Ромите имаат право само еден ден во неделата да се капат на базен?“)', *Radio MOF*, 4 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/prijavena-diskriminacija-znaevte-li-deka-romite-imaat-pravo-samo-eden-den-vo-nedelata-da-se-kapat-na-bazen/>.

183 'QEDR: KPMD urdhëroi Shkollën Fillore "Giorgji Sugarev" të ndalojë ndarjen e fëmijëve romë (ЕЦПР: КСЗД му нареди на основното училиште „Ѓорѓи Сугарев“ да ја прекине сегрегацијата на ромските деца)', *Radio MOF*, 17 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/ERRC-kszd-mu-naredi-na-osnovnoto-uchilishte-gjorgji-sugarev-da-ja-prekine-segregacijata-na-romskite-deca/>.

184 'Pas diskriminimit të vendosur nga KPMD, Pushteti Lokal në Prilep mori urdhër për sigurimin e ujit të pijshëm për vendbanimet rome (По утврдена дискриминација од КСЗД, локалната власт во Прилеп доби наредба да обезбеди питка вода за ромските населби)', *Radio MOF*, 25 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/po-utvrdena-diskriminacija-od-kszd-lokalnata-vlast-vo-prilep-dobi-naredba-da-obezbedi-pitka-voda-za-romskite-naselbi/>.



